



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo

Pranuar - Primitjeno Më/Dana <u>19.04.2012</u>			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednos
<u>02-013/hjt</u>			

Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 40 paragrafi 2 pika c.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Gazeta zyrtare nr 28/2008, nenit 35 paragrafi 2 pika c) të Statutit të Komunës së Vitisë nr 013/491 të datës 21.04.2011, dhe kërkesës së Këshillit të fshatit Ramjan, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 18.04.2012 aprovon këtë:

**V E N D I M**  
**PËR ANULIMIN E POZICIONIT NGA BUXHETI I KOMUNËS SË VITISË PËR**  
**VITIN 2012 "NDËRTIMI I UJËSJELLËSIT NË FSHATIN RAMJAN"**

Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendit të Komunës së Vitisë, ANULON pozicionin nga buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2012 "Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Ramjan".

Me buxhetin e aprovuar për vitin 2012 në listën e projekteve të investimeve publike për vitin 2012 nën numrin rendor 10 është paraparë "Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Ramjan" në shumë prej 70.000,00€.

Neni 2

Anulimi i pozicionit nga neni 1 i këtij propozim vendimi bëhet në bazë të kërkesës së Këshillit të fshatit Ramjan nr 06-07/257 të datës 02.03.2012, me arsyetim se Këshilli i fshatit Ramjan i jep përparësi Rregullimit të kanalizimit në fshatin Ramjan.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Vitisë.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Drejtorisë për Financa
2. Këshillit të fshatit
3. Arkivit

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË

K R Y E S U E S I

Skenderbe Hebibi

